

VENDIM
Nr. 228, datë 17.4.2025

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 132, DATË 6.3.2024, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
AGJENCISË KOMBËTARE TË EKONOMISË SË MBETJEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 132, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”, bëhen këto shtesa:

1. Pas shkronjës “a”, të pikës 1, të kreut II, shtohet shkronja “a/1”, me këtë përmbajtje:
“a/1) të kryejë detyrat e autoritetit kontraktor për ministrinë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve për projektet/kontratat ekzistuese dhe të ardhshme të infrastrukturës së mbetjeve.”.
2. Pas shkronjës “c”, të pikës 7, të kreut III, shtohet shkronjat “c /1”, me këtë përmbajtje:
“c/1) shqyrton, autorizon e miraton, për ministrinë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve, në cilësinë e autoritetit kontraktor, procese që kanë të bëjnë me projektet/kontratat ekzistuese dhe të ardhshme të infrastrukturës së mbetjeve të lidhura sipas legjislacionit në fuqi për koncesionet e partneritetin publik dhe të atij të prokurimit publik, dhe mban korrespondencën e koordinon me të kontraktuarit, institucionet dhe subjektet, të cilat janë palë në kontratat e lidhura.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku